



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:133935

Datë: 20.03.2025

Numri i dokumentit: 07020064

C.nr.1070/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje me gjyqtarin Skender Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.G.A, A.G.A., A.I., nga Mitrovica të cilat sipas autorizimit më shkrim i përfaqëson Amir Bunjaku, avokat me seli në Prishtinë, kundër të paditurës KM - DKA , të cilat sipas autorizimit më shkrim i përfaqëson Lirim Zeka, avokat më seli në Prishtinë, me objekt kontesti “*Kompensim i të ardhurave nga marrëdhënia e punës*”, jashtë seance gjyqësore, datën 20.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË POHIMIT

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësve A.G.A, A.G.A., A.I., nga Komuna e Mitrovicës, pjesërisht e bazuar.
- II. DETYROHET e paditura KM - DKA, që paditësve t’ia paguajë kompensimin në emër të kompensimit për ushqim gjatë pranisë në punë (shujtave ditore), dhe atë:

Për paditësen e parë A.G.A,

- për (102) ditë pune (për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga 2 euro), t’ia paguajë shumën e tërësishme prej (199.08) Euro (*njëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro*), me kamatë ligjore prej 8 për qind, e cila do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë në gjykatë (29.06.2022) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto (borxhin kryesor dhe kamatën ligjore) në afatin prej 7 (*shtatë*) ditësh, nën kërcënim të përmbarimit.

Për paditësen e dytë A.G.A,

- për (97) ditë pune (për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga 2 euro), t’ia paguajë shumën e tërësishme prej (194) Euro (*njëqind e nëntëdhjetë e katër euro*), me kamatë ligjore prej 8 për qind, e cila do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë në gjykatë

(29.06.2022) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto (borxhin kryesor dhe kumatën ligjore) në afatin prej 7 (*shtatë*) ditësh, nën kërcënim të përmbarimit.

III. KONSTATOHET se padia e paditëses A.I. nga Mitrovica e ushtruar kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës për kompenzimin në emër të kualifikimit në lartësi prej 27% të pagës vjetore kumulative për periudhën 01.01.2020 e deri me 01.02.2023, është tërhequr.

IV. OBLIGOHET e paditura K.M-DKA, t'ia paguajnë paditëses shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej (98) Euro , të gjitha në afat prej 7 (*shtatë*) ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditëset A.G.A, A.G.A., A.I., nga Mitrovica, nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë (29.06.2022), pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës K.M-DKA, me objekt kontesti "*kompensimin i të ardhurave nga marrëdhënia e punës*".

Tutje me datë 27.11.2023 i autorizuari i paditësve në këtë gjykatë ka parashtruar precizim të kërkesëpadi së duke e tërhequr padinë e paditëses A.I., e ushtruar për kompenzimin në lartësi 27% të pagës vjetore për periudhën 01.01.2020 e deri me 01.02.2023, të paraparë me Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, fillimisht vërejtë se padia është përpiluar në tërësi në përputhje me dispozitën nga neni 253, lidhur me nenin 99 të LPK, pas plotësimit të kushteve ligjore, të njëjtën (padinë me dokumentet e bashkangjitura në të), më Aktvendimin që mbanë shenjen C.nr.1070/2022, të datës 15.01.2025, e detyron të paditurën që në afatin prej 15 ditësh të paraqes përgjigje në padi, nën kërcënimin e pasojave juridike. Tutje, e paditura më parashtrësën e datës 14.03.2025, (përgjigjen në padi) e ka pohuar kërkesëpadi në e paditëses sa i përket shujtës ushqimore.

Gjykata pas pohimit të kërkesëpadi së nga ana e të paditurit, konstatoi se në këtë çështje kontestimore kemi të bëjmë me kërkesë me të cilën palët mund të disponojnë lirshëm, në kuptim të nenit 148 paragrafit 1 të LPK, me të cilin përcaktohet se "*në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadi në pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadi në (aktgjykimi në bazë të pohimit)*" vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në pikën II të dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, duke u bazuar në dispozitën e nenit 7 paragrafi 1 të LPK, ku shprehimisht thuhet *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohet faktet e tilla”*, ndërsa me dispozitën e nenit 319 paragrafi 1 dhe 2, të po të njëjtit ligj shprehimisht thuhet *“Secila nga palët ndergjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, ku të provuarit përfshihen në të gjitha faktet që janë të rëndësishme për dhënien e vendimit”*.

Gjykata pasi ka analizuar gjendjen faktike dhe pretendimet e palëve, paditesit të cilët në gjykate me anë të të autorizaurit të tyre kanë bërë precizimin duke e tërhequr kompensimin prej 25 % për shtesën në pagë në emër të licensimit dhe atë për periudhën nga data 01.01.2020 deri me 01.02.2023, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, konform nenit 261 par.1 të LPK-së, i cili shprehimisht parasheh se *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi.”* lidhur me paragrafin 3 të po këtij neni i cili përcakton se *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë.”*

Lidhur me kumatën ligjore të kërkuar nga paditësi, duke qenë se e paditura, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, gjykata ka vendosur që kumatë vonesa të jetë prej 8%, duke u bazuar në nenin bazuar në nenin 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit padisë në gjykatë (08.11.2024), bazuar në Mendimin Juridik për Kumatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur nga paraqitja e padisë është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 të LPK, sipas të cilit pala e cila e humb kontestin tërësisht ka për detyrë që, palës kundërshtare, t’ia kompensojë shpenzimet gjyqësore. Në rastin konkret pala e paditur ka për obligim që paditëses të ia paguaj shpenzimet procedurale në emër të përpilimit të padisë, në shumën prej 78 Euro, dhe në emër të taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë si dhe duke u bazuar në nenin 148 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

C.nr.1070/2022, datë 20.03.2025

GJYQTARI

Skender Shala

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkak se deklarata e pohimit, është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.